

REFORMA NË ADMINISTRATËN PUBLIKE NË KUADËR TË PROCESIT TË INTEGRIMIT NË BASHKIMIN EUROPIAN



Përgatiti:

Brunilda Tushaj Pellumbi
Jonida Llaci
Dorilda Kaculi
Orion Jucja

Nëntor 2023

Ky Ky dokument u prodhuan si pjesë e iniciativave publike të pjesëmarrësve dhe alumnëve të "Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike". Mendimet, gjetjet dhe rekomandimet e shprehura janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Akademisë së Studimeve Politike, si zbatuese e këtij programi

Hyrje



Reforma në administratën publike në Shqipëri është një proces i domosdoshëm dhe i vazhdueshëm, i lidhur ngushtë me procesin e integritit në Bashkimin Evropian (BE). Kjo reformë është ndër prioritetet e qeverisë shqiptare si një instrument kyç për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve dhe biznesit, dhe si kusht për proceset integruese të vendit.

Në sektorë kyç, administrata publike përballlet me sfida të mëdha në realizimin e detyrave të veta, të cilat lidhen me qëndrueshmërinë dhe depolitizimin, krijimin e mekanizmave efikasë të kontrollit, zbatimin me rigorozitet të ligjit të nëpunësit civil dhe realizimin e procedurave transparentetë rekrutimit, rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara ndaj qytetarëve, luftën ndaj korrupsionit, dhe përdorimin e mjeteve të teknologjisë së informacionit në ofrimin e shërbimeve.

Prioritet i rëndësishëm do të vazhdojë të jetë krijimi i një administrate të qëndrueshme dhe të aftë për të përballuar sfidat e zhvillimit të vendit, dhe prioritetet e anëtarësimit në BE. Në këtë kontekst, në kuadër të proceseve integruese, administrata shqiptare do duhet të ofrojë një profesionalizëm të punonjësve të saj, në përmirësimin e procesit të politikbërjes dhe hartimit të legjislacionit, në organizimin eficient të strukturave, rritjen e përgjegjshmërisë së punonjësve, transparencën dhe përmirësim të shërbimeve ndaj publikut.

Në një perspektivë afatgjatë do të duhet të synohet rritja e qëndrueshmërisë së punonjësve të administratës publike, nëpërmjet zbatimit me rigorozitet të procedurave të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi, forcimit të kapaciteteve nëpërmjet trajnimit të thelluar dhe të vazhdueshëm të nëpunësve të administratës publike qendrore dhe vendore.

Objektivi kryesor i analizimit të situatës dhe përmirësimeve të caktuara në procesin e reformës së administratës publike në drejtim të integritit në Bashkimin Evropian është të përmirësohet efikasiteti, transparenca, përgjegjshmëria dhe efektshmëria e sistemit të administratës publike, në përputhje me standartet dhe kërkesat e Bashkimit Evropian.

Përputhje me Standardet e BE-së, nënkupton sigurimin që sistemi i administratës publike përputhet me standartet, rregullat dhe praktikat më të mira të Bashkimit Evropian duke identifikuar boshllëqet dhe mospërputhjet midis sistemit aktual dhe kërkesave të Bashkimit Evropian për të zhvilluar një rrugëtim për rregullime dhe reforma të nevojshme.

Përshkrimi i problemit

Administrata Publike në Shqipëri përballet me një sërë sfidash që kërkojnë reforma dhe përmirësime gjithëpërfshirëse. Këto çështje janë të lidhura thelbësisht me aspiratat e vendit për integrim në Bashkimin Evropian (BE), pasi një administratë publike e modernizuar, efikase dhe e përgjegjshme është një kërkesë themelore për integrim të suksesshëm. Problemet dhe sfidat kryesore të mëposhtme ofrojnë një përshkrim të detajuar të problemit:

Qëndrueshmëria dhe depolitizimi: Administrata publike vazhdon të përballet me çështjet e qëndrueshmërisë dhe depolitizimit. Ndikimi politik dhe emërimet e nepotike mbeten të përhapura, duke ndikuar në paanshmërinë dhe efektivitetin e institucioneve publike. Problemi qëndron në sigurimin që nëpunësit civilë të emërohen në bazë të meritave dhe jo të lidhjeve politike.

Mekanizmat e kontrollit: Në administratën publike mungojnë mekanizmat efikasë të kontrollit. Sistemet aktuale për monitorimin dhe vlerësimin e veprimeve dhe shpenzimeve të qeverisë janë shpesh joefektive. Kjo krijon mundësi për keqpërdorim të burimeve publike dhe korrupsion. Forcimi i mekanizmave të kontrollit është jetik për të rritur përgjegjshmërinë dhe transparencën.

Zbatimi rigoroz i ligjit për shërbimin civil: Zbatimi i ligjit të shërbimit civil është i paqëndrueshëm, duke çuar në një nivel të pabarabartë profesionalizmi midis punonjësve publik. Ekziston një kuadër ligjor i fortë, por zbatimi i tij shpesh dështon. Sigurimi i respektimit të rreptë të këtyre ligjeve është i nevojshëm për të përmirësuar cilësinë dhe profesionalizmin e shërbimit publik.

Procedurat transparente të rekrutimit: Procedurave të rekrutimit për pozicionet publike u mungon transparenca, duke favorizuar potencialisht nepotizmin dhe miqësinë. Kjo rezulton në mungesë besimi në institucionet publike dhe minon më tej depolitizimin e administratës.

Cilësia e Shërbimeve Publike: Cilësia e shërbimeve të ofruara për qytetarët ka nevojë për përmirësim. Përmirësimi i proceseve administrative, reduktimi i burokracisë dhe rritja e efikasitetit të ofrimit të shërbimeve publike është thelbësore për rritjen e kënaqësisë dhe besimit publik.

Korrupsioni: Korrupsioni mbetet një sfidë e vazhdueshme brenda administratës publike. Trajtimi i kësaj çështjeje është thelbësor si për qeverisjen efektive ashtu edhe për të fituar besimin e institucioneve të BE-së.

Qëndrueshmëria e punonjësve: Qëndrueshmëria afatgjatë e punonjësve është një çështje thelbësore në administratën publike, pasi ekziston nevoja për të siguruar që nëpunësit civilë të mbeten të përkushtuar dhe kompetent. Kjo kërkon respektim të vazhdueshëm të procedurave ligjore, ngritje të vazhdueshme kapacitetesh përmes trajnimeve dhe fokus në zhvillimin e karrierës.

Objektivi parësor i përpjekjeve për reforma në administratën publike të Shqipërisë duhet të jetë adresimi i këtyre sfidave, harmonizimi i sistemit me standardet e BE-së dhe krijimi i një administrate publike më efikase, transparente dhe të përgjegjshme. Kjo jo vetëm që do t'i shërbejë interesave të qeverisjes së mirë, por gjithashtu do t'i mundësojë vendit të përmbushë me sukses kërkesat për integrim në BE.

Analiza e problemit

Një ndër problemet kryesore është ndikimi i politikës në administratën publike. Emërimet e bazuara në lidhje politike dhe nepotizmi kanë rritur pabarazinë dhe uljen e nivelit të besueshmërisë në institucionet publike. Ndërhyrjet politike shpesh kanë ndikuar në ndryshimin e drejtuesve të institucioneve nëpërmjet shkarkimeve të papritura ose emërimeve të reja politike. Kjo mungesë stabiliteti pengon zhvillimin e projekteve afatgjata dhe krijon vështirësi në implementimin e politikave të qëndrueshme.

Interesi kryesor kombëtar dhe qëllimi strategjik i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë është anëtarësimi në BE. Kriteret e anëtarësimit përcaktojnë qartë stabilitetin e institucioneve që garantojnë demokracinë, sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut, si edhe ekzistencën e një ekonomie tregu funksionale, të cilat përbëjnë shtyllat e politikës kombëtare dhe politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë.

Për sa i takon administratës publike, një ndër komponentët më të rëndësishëm të Reformës në Administratën Publike, referuar edhe rekomandimeve të Progress Raportit 2023, është zbatimi i reformës së Shërbimit Civil dhe Menaxhimi i Burimeve Njerëzore. Pavarësisht avancimit domethënës në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe përmirësimit të procesit të rekrutimit në shërbimin civil, në Administratën Publike ekziston ende hendeku midis kuadrit ligjor e politik dhe zbatimit të tij në administratën publike në Shqipëri. Administrata publike shqiptare karakterizohet ende nga karriera të paqëndrueshme, shkallë të lartë të ndryshimeve në radhët e saj të pasqyruara në përvojën e pakët të punonjësve civilë, si dhe kohë pas kohe turbullohet nga praktika të këqija, korrupsioni, abuzimi me pushtetin dhe ndikimi i politikës. Ky vështrim i përgjithshëm shoqërohet me një skepticizëm mbi zbatimin e parimeve të demokracisë përfshirëse që duhet të adresohet me kujdes në një kohë ku bashkëpunimi me qytetarët dhe shoqërinë civile po kthehet në një themel për reformat dhe zhvillimet e sektorit publik në përgjithësi.

Zbatimi i duhur i legjislacionit të shërbimit civil dhe monitorimi i tij tashmë janë thelbësore për avancimin e Shqipërisë drejt Integritit European. Elementë kyç në këtë drejtim janë gjithashtu, mirëfunksionimi dhe pavarësia e Komisionerit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil (KMSHC), si edhe praktikat transparente të bazuara në meritokraci, sidomos në rekrutimet në administratën publike. Ndërtimi i një mekanizmi të plotë monitorimi gjithëpërfshirës është thelbësor.

Në këtë kontekst, promovimi i depolitizimit në administratën publike ka për qëllim të sigurojë qëndrueshmërinë dhe depolitizimin brenda administratës publike duke vënë theksin tek rekrutimet e bazuara në merita dhe të përqëndruara në aftësi, si dhe duke punuar ngushtë për të arritur stabilitetin afatgjatë të punonjësve. Kjo qasje promovon një fuqi punëtore profesionale dhe të kualifikuar, duke nxitur kulturën e kompetencës profesionale dhe duke reduktuar ndikimin e lidhjeve politike.

Fokusimi në angazhimin dhe stabilitetin afatgjatë të punonjësve brenda administratës publike dhe përmirësimi dhe zbatimi i programeve të zhvillimit të karrierës, iniciativave të mentorimit dhe trajnimit të vazhdueshëm për të rritur aftësitë dhe përkushtimin e punonjësve, kontribuon në efikasitetin, efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e administratës publike.

Sigurimi i pavarësisë së institucioneve nga ndikimi politik dhe promovimi i transparencës do të ndihmojë në rritjen e besueshmërisë dhe efektivitetit të administratës publike dhe arritjen e standarteve Europiane.

Përcaktimi i metodologjisë dhe teknikave për zhvillimin e një teze mbi reformën e administratës publike në drejtim të integrimit në BE përfshin qasjen kërkimore, metodat e mbledhjes së të dhënave, teknikat e analizës, krahasimeve, etj.

Për mbledhjen e informacione reference, bazë ishte analiza e dokumentave duke përfshirë rishikime të raporteve ndërkombëtare, analizat e dokumentave strategjike, gjetje dhe publikime të misioneve të atashuara në Shqipëri si OSBE-ODHIR, trupat diplomatike, etj të cilët kanë ndjekur ngushtësisht procesin e integrimit të Shqipërisë dhe reformën e administratës publike si pjesë e saj. Një bazë e rëndësishme e të dhënave të cilat ishin si ndihmesë edhe për përgatitjen e rekomandimeve ishin progress-raportet e BE-së për Shqipërinë, veçanërisht progres-raporti i fundit i publikuar në nëntor të vitit 2023.

Krahasimi i praktikave të ndjekura për çështjen e reformës në administratën publike dhe përafrimet sipas të dhënave për BE-në dhe hapat e ndjekura konkretisht nga Shqipëria ishte gjithashtu një instrument i përdorur gjatë këtij punimi për të arritur në rekomandime sa më realiste dhe të përshtatshme me realitetin shqiptar. Komentet apo raportet vjetore nga institucionet shtetërore ishin gjithashtu pjesë e kësaj pune kërkimore.

Duke përmbledhur të gjithë metodologjinë piketat kryesore ishin si mëposhtë:

- a) Analiza e dokumenteve strategjike/ Desk Research
- b) Krahasim i praktikave

Rekomandimet Aktuale



Sipas Progres-Raportit nga Komisioni European të datës 8 Nentor 2023, mbeten në fuqi rekomandimet e vitit 2022, se Shqipëria duhet:

- të vendosë një kuadër legjislativ që rregullon sic duhet tipologjinë dhe kriteret për krijimin e organeve vartëse dhe qartëson linjat e llogaridhënies
- të miratojë dhe fillojë zbatimin e strategjive të reja të menaxhimit të administratës publike dhe finacave publike, si dhe rishikimi i efektivitetit të strukturave aktuale të monitorimit
- të zbatojë në mënyrë të vazhdueshme dhe efektive dispozitat për rekrutimin, ngritjen në detyrë dhe shkarkimin e bazuar në meritokraci në ligjin për shërbimin civil në të gjitha nivelet, veçanërisht në atë të lartë; vazhdimi i reformimit të sistemit të pagave për nëpunësit civilë dhe rifillimi i automatizimit të sistemit të pagave.

Rekomandime të mëtejshme




Pas analizës së thelluar të reformës së administratës publike në kuadër të procesit të integritimit në Bashkimin Evropian, do të mund të jepen disa rekomandime të rëndësishme që mund të ndihmojnë në përmirësimin e procesit dhe suksesit të këtij rrugëtimi të rëndësishëm. Këtu mund të përmendim disa rekomandime që mund të konsiderohen:

- **Intensifikimi i Edukimit dhe Trajnimit:** Qeveria shqiptare duhet të investojë në programe të ndërtimit të kapaciteteve dhe trajnimeve për punonjësit e administratës publike për t'u pajisur me shkathtësitë dhe njohuritë e nevojshme për integrimin në Bashkimin Evropian. Ky proces përfshin trajnime në politikat, procedurat dhe praktikat administrative të BE-së.
- **Depolitizimi i Administratës Publike:** Qeveria shqiptare duhet të sigurojë qëndrueshmërinë dhe depolitizimin e administratës publike, duke u fokusuar në punësimin në bazë të meritës dhe aftësisë, si dhe duke punuar ngushtësisht për arritjen e qëndrueshmërisë afatgjatë të punonjësve. Fuqizimi i zbatimit rigoroz i ligjit për shërbimin civil dhe transparenca në rekrutime shërbejnë si pika kyçe të rritjes së besimit të publikut dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara ndaj tyre.
- **Krijimi i Mekanizmave të Përshtatshëm të Monitorimit dhe Vlerësimit:** Ngritja e mekanizmave efektive të kontrollit, nga ana tjetër është një sfidë lidhur me aktivitetin e punonjësve të administratës publike, duke ndihmuar për të pasqyruar kështu një aktivitet të qartë të Administratës Publike.
- **Fokusimi në Transparencë dhe Përgjegjshmëri:** Përmirësimi i proceseve administrative me fokus rritjen e efikasitetit të shërbimeve të ofruara ndaj qytetarëve, duke synuar luftën ndaj korrupsionit dhe rritjen e kapaciteteve duhet të jetë fokus i qeverisë shqiptare. E drejta e qytetarëve për administrim të mirë duhet të forcohet. Duke ju referuar një konsultimi publik për ndryshimin e ligjit për të drejtën e informimit në vitin 2021, e drejta e qytetarëve për akses në informacione publike duhet rritur ndaj duhet të jetë referencë e fortë për qeverinë shqiptare.

Këto rekomandime synojnë të forcojnë procesin e reformës në administratën publike në drejtim të integritimit në Bashkimin Evropian dhe të sigurojnë një përmirësim të qëndrueshëm dhe të suksesshëm të këtij procesi të rëndësishëm.


Shtojca

Grafiku 1 Statusi i përgjithshëm i realizimit të nënaktiviteteve gjatë vitit 2022




■ Realizuar plotësisht ■ Realizuar pjesërisht

Grafiku 2 Numri i nën-aktiviteteve të realizuara plotësisht gjatë vitit 2022



■ Realizuar plotësisht ■ Realizuar pjesërisht

Grafiku 3 Numri i nën-aktiviteteve të realizuara plotësisht sipas shtyllave



Fusha I “Politikëbërja dhe cilësia e legjislacionit”

Janë realizuar 36 nënaktivitete nga 48 në total.

Fusha II “Organizimi dhe funksionimi i Administratës Publike”

Janë realizuar 14 nënaktivitete nga 18 në total.

Fusha III “Shërbimi civil: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore”

Janë realizuar 28 nënaktivitete nga 36 në total.

Fusha IV “Procedurat Administrative dhe Mbikëqyrja”

Janë realizuar 25 nënaktivitete nga 30 në total.

Bibliografia



- National PAR Monitor Albania 2022 www.idmalbania.org
- Albania Report on the preparation of post 2020 strategy RCC
- Albania Screening Report 2022 : neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-07/AL%20Cluster_1%20Draft%20screening%20report_ext_ernal%20version.pdf
- Evaluation Report of the previous Albania PAR Strategy
- DoPA PAR Strategy 2018-2020 www.dap.gov.al
- SIGMA Report
- 11th Meeting of PAR special group EU & Albania
- <https://www.respaweb.eu/25/research> The EU support to PAR through the IPA II an overview and lessons learned, Regional Conference IPA III Take away and Conclusions, National Study on policy coordination processes in Albania
- National Strategy for Development and Integration 2015-2022
- https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf